



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL



KGJK.nr.112/2024
Datë: 23 prill 2024

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 10.1 dhe nenit 36 të Rregullores Nr. 07/2023 Për procedurën e certifikimit, emërimit, kushtet, të drejtat, detyrimet dhe shpërblimin dhe disiplinimin e përkthyesve dhe interpretëve gjyqësor, në takimin 325, të mbajtur me datë 23 prill 2024, merr këtë:

V E N D I M

I. Plotësohet lista e përkthyesve dhe interpretëve gjyqësorë të certifikuar më parë me aktvendim nga ish Gjykatat e Qarkut dhe të njejtit certifikohen dhe emërohen sipas listave të bashkangjitura për këto çifte të gjuhëve :

Shqip–Kroatisht dhe Anasjelltas, dhe
Shqip–Italisht dhe Anasjelltas.

II. Obligohet Udhëheqësja e Zyrës së Përkthimeve, t’i ndërmarr të gjitha veprimet të cilat rrjedhin nga legjislacioni në fuqi, me qëllim të zbatimit të pikës I, të dispozitivit të këtij vendimi.

III. Vendimi hyn në fuqi më 23 prill 2024.

Albert ZOGAJ

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Kopje e vendimit i dërgohet:

- Gjykatave të Republikës së Kosovës;
- Sekretariatit të KGJK-së, si dhe
- Arkivit.